

# Projekti i APPK-së VEND-KS Të arrish i përgatitur në Gjermani

Vazhdon më tutje prej 04.2020-06.2022



**Das Projekt wird finanziert durch den Europäischen Asyl-, Migrations-, und Integrationsfonds, die Bundesrepublik Deutschland und die Diakonie**

Përgjegjës për Kosovë: Diakonisches Werk Baden në bashkëpunim me Diakonischen Werke Württemberg, nën implementim të APPK-së (Kosovë).

## ♦ Qëllimi i projektit

Ofrimi i shërbimeve të tilla që përmes këshillimeve individuale, trajnimeve grupore dhe takimeve informuese, të përkrahën qytetarët kosovarë në rrugëtimin e tyre të migrimit legal nga Kosova në Gjermani.

## ♦ Grupet synuese

Qytetarët kosovarë të cilët synojnë migrimin legal në Gjermani për ndonjë prej arsyeve, si: bashkim familjar, punësim, shkollim dhe aftësim profesional (Ausbildung), studime., e të cilët ballafaqohen me temat:

- Aspekti administrativ i bashkimit familjar, si të procedohet bashkimi familjar i suksesshëm?
- Rrugët dhe format e hulumtimit të një vendi pune apo aftësimi profesional?
- Çfarë duhet të bëjë për të gjetur një vend pune apo një vend për aftësim profesional?
- Mënyra dhe procedurat e njohjes së dokumenteve kualifikuese, dhe
- Çështje tjera të përgjithshme, të ndërlydhura me proceset e migrimit legal.

## ♦ E rëndësishme

Te interesuarit këshillohen dhe informohen, në mënyrë profesionale. Këshillimet jepen vetëm në interes të njerëzve që këshillohen (pavarësisht nga tema e këshillimit). Këshillat janë konfidenciale, këshilltarët i nënshtrohen konfidencialitetit.

Ekipi këshillues nuk ofron shërbime të tilla që kanë të bëjnë me plotësimin e formularëve të ndryshëm, kërkimin e një vendi të punës ose vendi për aftësim profesional. Aktivitetet e tilla duhet të kryhen nga vet kandidati.


Të gjitha shërbimet janë **pa pagesë**.


Aktivitetet e ekipit këshillues, si dhe shpenzimet e tjera të APPK-së në këtë projekt, financohen nga fondet e BE-së, fonde nga Republika Federale e Gjermanisë dhe fonde nga Diakonie.

## Si të na kontaktoni:

### **1. Përmes telefonave:**


+383 38 554 155

 +383 38 554 166

+383 44 507 628 (edhe në Viber) 

Administrata e jonë i merr shënimet lidhur me kërkesën tuaj dhe, në kohën sa me të shkurt të mundshme, njeri prej bashkëpunëtorëve të projektit VEND-KS ju kontakton dhe iu ofron të gjitha informatat e pritura nga ju.

### **2. Përmes E-mail në:**

 [info@appk.org](mailto:info@appk.org)

Ju shkruani kërkesën apo pyetjen tuaj, administrata e përcjell kërkesën apo pyetjen tuaj tek njëri prej bashkëpunëtorëve të projektit (varësisht prej karakterit të kërkesës apo pyetjes) dhe në kohën sa me të shkurt të mundshme ju do të merrni një informatë kthyesë gjithashtu përmes E-Mail.

Ekipi i projektit do të organizojë edhe:

- Trajnime grupore me tema të para integritit në Gjermani si dhe
- Takime informuese grupore, me tema aktuale që e përcjellin migrimin legal.

### **Si të merrni pjesë:**

Ekipi i projektit shpallë në WEB dhe Facebook të APPK-së ditën e trajnimit apo takimit informues me temat përkatëse, si dhe mënyrën se si të merrni pjesë në këto ngjarje.

Të gjitha shërbimet e mësipërme vazhdojnë të ofrohen online deri sa të krijohen kushtet që të njëjtat të mbahen në hapësirat moderne të APPK-së.

Jeni të mirëpritur

**Stafi i projektit VEND-KS nga APPK**

[www.legal-migration.de](http://www.legal-migration.de)